



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS
01Nr. 104/02-11652 /2022
Kaçanik, 29.04. 2022

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 8 të Udhëzimit administrativ Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësja civile, Fatlume Guri, Zyrtare për informim dhe monitorim të mediave, caktohet Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike në Komunën e Kaçanikut.
2. Obligohet e lartpërmendura të veprojë duke u mbështetur në Udhëzimin administrativ Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Duke pasur parasysh rëndësinë e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në proceset e konsultimit publik, të palëve të interesuara dhe publikut në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes publik si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe publikut, kryerjes së detyrave të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi për të zbatuar në formë efektive procesin e konsultimeve publike gjatë hartimit të legjislacionit dhe politikave, u vendos që të caktohet një zyrtarë përkatës për koordinim të procesit të konsultimit me publikun, i cili ka përgjegjësinë e krijimit të një sistemi efektiv të raportimit për zbatimin e standardeve minimale për konsultim me publikun si dhe të mbështetjes së vazhdueshme të zyrtarëve përgjegjës për hartimin e politikës dhe legjislacionit.

Andaj, duke pasur parasysh këto që i theksuam më lartë, përgatitjen profesionale të zyrtares dhe përvojën e punës, u konstatua se Zyrtarja Fatlume Guri mund të kryen detyrat e cekura më lartë.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen;

-znj. Fatlume Guri

-Udhëheqësi i personelit

Kryetari i Komunës
z.Besim Ilazi

